- License leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit , kodi II.1.B (shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez).
- License leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit , kodi II.1.A (1), Prodhim, perpunim shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez)
- License leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit , kodi II.1.C (fruta perime)

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vertetim per xhiron ushtrimore te 3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit, pra për vitet 2015, 2016, 2017. Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve duhet të jetë në masën 40% të vlerës se fondit limit te objektit te prokurimit per te cilin ofertuesi konkuron , te leshuar nga Dega e tatim Taksave.

2.2.2 Kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2015, 2016, 2017) të konfirmuara nga organet tatimore

2.2.3 Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2018, sipas vendushtrimit te aktivitetit te pasqyruar ne QKR.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike per piken 2.2.1 si edhe piken 2.2.2 duhet ti plotesoje secili prej operatoreve anetare te bashkimit ne perputhje me marreveshjen e bashkepunimit.(sipas % te kontrates se bashkepunimit) ; ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike per pikat 2.2.3 duhet ti plotesoje secili prej operatoreve anetare te bashkimit ;

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% të vlerës se fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me institucione shtetërore kërkohen kontrata e shoqeruar me vërtetim realizimit te kontrates të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes ku te shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kritereve te mesiperm e ben oferten te vlefshme

Ne lidhje me pikat e mesiperme (2.3.1) ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, ne varesi te marreveshjes se bashkepunimit secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriteret e mesiperm ne perputhje me marreveshjen e bashkepunimit (sipas % te kontrates se bashkepunimit).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e meposhtme:

- **HACCP** (Certifikata duhet te jete e shoqeruar me raport auditimi nga enti certifikues)
- **ISO 22000** (Certifikata duhet te jete e shoqeruar me raport auditimi nga enti certifikues)
- **ISO 9001:2015** (Certifikata duhet te jete e shoqeruar me raport auditimi nga enti certifikues)
- **ISO 28000:2007** (Certifikata duhet te jete e shoqeruar me raport auditimi nga enti certifikues)

Ne lidhje me kete pike ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike , secili prej anetareve te bashkimit duhet te disponojne certifikatat e mesiperme

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te jete i licencuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ne lidhje me mallrat objekt i kesaj kontrate, QKL per shitje me shumice te ushqimeve me origjine shtazore (per njerez).

Ne lidhje me kete pike ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike , secili prej anetareve te bashkimit duhet te disponojne licencen e mesiperme.

2.3.5 Operatori duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim kundrejt kontratave perkatese te noterizuara ambjente te pershtatshme per periudhen e zbatimit te kontrates si me poshte:

- a) Subjekti duhet te kete njesi tregtimi ose magazine ushqimore ne pronesi ose kontrate qeraje noteriale e cila duhet te jete e pajisur me
- ✓ Akt Miratim Higjeno-Sanitar te leshuar nga autoritetet perkatese te Ministrise se Shendetesie
 - ✓ License nga leshuar nga QKB
 - ✓ Certifikate e dezinfektimit 3 D (periudha e dezinfektimit duhet te jete brenda afatit te garacise, pra duhet te jete e vlefshme ne kohen e hapjes se ofertave)
- b) Subjekti duhet te kete njesi prodhimi per bulmet ose njesi tregtimi bulmeti ne pronesi ose kontrate qeraje noteriale e cila duhet te jete e pajisur me
- ✓ Akt Miratim Higjeno-Sanitar te leshuar nga autoritetet perkatese te Ministrise se Shendetesie
 - ✓ Leje mjedisore leshuar nga QKB
 - ✓ License nga leshuar nga QKB

(Lidhur me kete pike eshte e vlefshme nga ofertuesi dhe paraqitja e nje kontrate bashkepunimi ose furnizimi me shoqeri private te licensuar sipas ligjeve ne fuqi)

- c) Furre buke (ne pronesi ose kontrate qeraje noteriale) e cila duhet te jete e pajisur me
- ✓ Akt Miratim Higjeno-Sanitar te leshuar nga autoritetet perkatese te Ministrise se Shendetesie
 - ✓ License nga leshuar nga QKB
 - ✓ Leje mjedisore leshuar nga QKB
 - ✓ Certifikate e dezinfektimit 3 D (periudha e dezinfektimit duhet te jete brenda afatit te garacise,

pra duhet te jete e vlefshme ne kohen e hapjes se ofertave)

d) Pike Therje (thertore, ne pronesi ose kontrate qeraje noteriale) e cila duhet te jete e pajisur me

- ✓ license leshuar nga QKL,
- ✓ Akt Miratim Higjeno-Sanitar te leshuar nga autoritetet perkatese te Ministrise se Shendetesie,
- ✓ Leje mjedisore
- ✓ Vertetim leshuar nga AKU qe thertorja eshte ne aktivitet.

(Lidhur me kete pike eshte e vlefshme nga ofertuesi dhe paraqitja e nje kontrate bashkepunimi ose furnizimi me shoqeri private te licensuar sipas ligjeve ne fuqi)

Ne lidhje me kete pike ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike keto kritere duhet permbushet te pakten nga nje operator ekonomik .

2.3.6 Ofertuesi duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim kundrejt kontrates perkatese te noterizuar, mjete transporti per gjithë periudhen e zbatimit te kontrates si me poshte:

- 1 (nje) Automjet te pershtatshem (frigorifer) per transportimin e mallrave ne perputhje me specifikimet teknike te shoqeruar me certifikaten e pronesise, siguracion, leje qarkullimi, aktin e kolaudimit te automjetit ne dispozicion, certifikate per trasport mallrash dhe Akt Miratim Higjeno – Sanitar.
- 1 (nje) Automjet te pershtatshem (jo frigorifer) per transportimin e mallrave ne perputhje me specifikimet teknike te shoqeruar me certifikaten e pronesise, siguracion, leje qarkullimi, aktin e kolaudimit te automjetit ne dispozicion, certifikate per trasport mallrash dhe Akt Miratim Higjeno – Sanitar.

Ne lidhje me piken e mesiperme ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike ,ne varesi te marreveshjes se bashkepunimit secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperme ne perputhje me marreveshjen e bashkepunimit.(sipas % te kontrates se bashkepunimit)

2.3.6 Te paraqiten flete-analiza origjinale te leshuara nga AKU jo me pare se 3 (tre) muaj nga hapja e ofertave per produktet: Sheqer, oriz, makarona, vaj vegjetal (luledielli), miell gruri, niseshte, recel frutash, kripe, buke, salce domatesh, sode buke, uthull, caj mali, Vaj Ulliri.

Ne lidhje me kete pike ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike , secili prej anetareve te bashkimit duhet te paraqese flete-analizat e mesiperme.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Dokumentat Standarde të Tenderit

Nr	Te dhena specifike te mallit	Verejtje
1	Sheqer: te jete i perbere nga kristale te imta, pa copa te ngjeshura dhe lende te huaja, i etiketuar, ne pako 1 kg, sipas standartit shteteror dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.	
2	Oriz: Te jete cilesor, te jete me kokrra te shendosha, te pastra, te zhveshura teresisht nga levozhga , pa shenja myku ose prishje. Ambalazhimi te jete i paketuar ne pako 1 (nje) Kg, dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.	
3	Makaronat: Te jene cilesore, te etiketuara sipas standartit shteteror. Te kete afatet e perdorimit dhe ambalazhimi te jete me pako 500 gr dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.	
4	Vaji vegjetal (gjelle) : te jete nenprodukt luledielli, i kulluar, i rafinuar, te mos kete papasterti. Ambalazhimi te jete ne shishe plastike 1 lit, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit, ne etikete te jete I shenuar dhe emri i prodhuesit	
5	Miell orizi : te jete cilesor, i etiketuar sipas standartit shteteror. dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit. Ambalazhimi te jete me pako 250 gr.	
6	Miell gruri : te jete cilesor , me Rreze 70-75 %, i bardhe, i paster, i etiketuar sipas standartit shteteror dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit. Ambalazhimi te jete me pako 1 (nje) kg.	
7	Niseshte: te jete cilesore, pluhur i bardhe i paster, pa lageshtire, i etiketuar sipas standartit shteteror dhe me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit. Ambalazhimi te jete me pako 1 kg, ne etikete te jete I shenuar dhe emri i prodhuesit	
8	Recel frutash: Te mos jete FIKU, te jete cilesor, me ngjyre dhe shije karakteristike, i etiketuar sipas standartit shteteror. Te jete I ambalazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht, jo me te medha se 1 kg, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit. Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU, ne etikete te jete I shenuar dhe emri i prodhuesit	
9	Biskota : te jene cilesore, me shije te mire, pa shenja myku ose prishje, te jene sipas standarteve shteterore, te ambalazhuara, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.	
10	Kripe industriale: Cmimi te jepet per nje kg, duhet Te jete e bardhe, e imet, pa lageshtire, e jodizuar, ambalazhuar me pako 500 gr, ose 1 kg, te jete sipas standarteve shteterore me afat skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.	
11	Mish vici : Te jete i fresket, prodhim vendi. Mishi te jete i cilesise se pare, te jete i kulluar mire, nga pjese kofshe te vicit ,i shoqeruar me raport analize nga Inspektoriati Veterinar, me vule ne mish, me perqindje te ulet dhjami dhe Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga inspektoriati Veterinar.	
12	Mish pule : Te jete i fresket, prodhim vendi. ne etikete te jete i shenuar dhe origjina e prodhuesit . Mishi te jete i cilesise se pare, i shoqeruar me raport analize nga Inspektoriati Veterinar, dhe Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga inspektoriati Veterinar.	
13	Proshute e ambalazhuar : te jetë e freskët, cilësi e mirë, prodhim vendi, te ketë shije të këndshme, erë karakteristike, me përqindje te ulët yndyrore. Të jetë e shoqëruar me fletë analize, të ketë emrin e prodhuesit dhe afatet e përdorimit.	
14	Qumesht/ Kos: Cmimi te jete per liter, Te jete lope, i fresket, i cilesise se pare, te jete i pasterizuar me permbajtjen e duhur te yndyrnave 1.5 % deri 2.%, te kete shije dhe eren e kendshme, pa shije te hidhur dhe djegese te percaktuara ne standartet shteterore.. Ambalazhimi te sillet me shishe plastike me vellim 1 liter ose 1.5 liter , i mbyllur me kapak	

Dokumentat Standarde të Tenderit

	hermetik . shoqeruar me fleten e analizes leshuar nga AKU dhe afatin e perdorimit. Transporti te behet me mjete te specializuara te shitesit ne oret e para te mengjesit.	
15	Gjalp: Te jete gjalp baxho, me shije te mire , pa lende te huaja ne perberje,cmimi i ofruar te jete per kg, i fresket, cilesor sipas standarteve , te jete i shoqeruar me flete analize nga AKU dhe te jete i shoqeruar me etiketen e firmes prodhuese ne ambalazh, dhe afatet kohore te perdorimit si dhe me date skadences te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU . Transporti te behet me mjete te mbuluara te destinuara per transport bulmeti.	
16	Djath : Cmimi I ofruar te jete per kg, te jete cilesor, I stazhionuar, te mos jete shume I kripur, pa njolla lende te huaj, te kete shije dhe ere te kendshme , pa shije te hidhur e djegese brenda kushteve teknike. Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU, dhe te kete etiketen e firmes prodhuese ne bidon. Afati I skadences te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU- se.Transporti te behet me makina te mbuluara te destinuar per transport bulmeti.	
17	Djath kaçkavall : të jetë cilësisë së mirë. Djath lope, nga pamja e jashtëme të jetë i pastër pa lëndë të huaja, me konsistence të njëtrajtshëmi stazhionuar. Te jete I paketuar me qeska, Të ketë shije dhe erë karakteristike të këndshme, pa hidhësi. Prodhim vendi I shoqëruar me fletë analize të ketë emrin e prodhuesit dhe afatet e përdorimit.	
18	Gjize: Cmimi I ofruar te jete per kg, te jete cilesor, pa kripe , pa njolla lende te huaj te mos jete e hidhur , me shije te kendshme, Brenda kushteve teknike. Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU, dhe te kete etiketen e firmes prodhuese ne ambalazh.. Afati I skadences ne etikete te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU .Transporti te behet me makina te mbuluara te destinuar per transport bulmeti.	
19	Veze : te jene pule, prodhim vendi, cmimi I ofruar te jete per kokerr, me keto cilesi: Te jene te fresketa ,te kene emrin e prodhuesit dhe te jete e shoqeruar me analizen e proves nga A.K.U. te kete te shenuar mbi levozhge kodin qe duhet te perkoje me kodin e vendosur ne fleten e analizes se A.K.U.	
20	Buke gruri : Te jete mase homogjene e pjekur mire ne masen 1 kg, pa ere dhe shije te huaj , Cilesia do te jete sipas standarteve shteterore. Buka te dergohet per konsum 3 – 5 ore pas pjekjes. Rrezja e miellit te jete 70-75 %. Ambalazhimin te behet ne leter dhe e prere ne feta buke dhe te jete e shoqeruar me raport analize nga A.K.U.	
21	Perimet dhe zarzavatete tjera: Te jene te cilesise se pare, te fresketa, sipas stines te ambalazhuara ne menyre qe te mos demtohen gjate transportit.	
22	Caj mali : Te jete I cilesise se pare, te jete I paster nga papastertite dhe barishtet. I thare ne kushte te mira , me eren dhe shijen karakteristike te cajit te Malit. Te jete I ruajtur ne gjendje te thate pa lageshtire	
23	Fruta : te jene te fresketa cilesia e pare, sipas stines	
24	Uthull rrushi : të jetë lëng i pastër, i kthjellët pa lëndë të huaja, të ketë erën dhe shijen karakteristike të uthullës, e ambalazhuar në shishe qelqi 1 L, të ketë emrin e prodhuesit dhe afatet e përdorimit.	
25	Vaj Ulliri : te jete nenprodukt ulliri, I kulluar I rafinuar, te mos kete papasterti, te mos jete I hidhur. Ambalazhimi ne shishe qelqi 1 L. Aciditeti 1%. Ne etikete te kete te shenuar emrin e prodhuesit dhe afatet e perdorimit.	
26	Sodë buke : të jetë pluhur I bardhë, e pastër, e njëtrajtshme, pa lagështirë, e paketuar me qeska 100g. të ketë emrin e prodhuesit dhe afatet e përdorimit.	

Dokumentat Standarde të Tenderit

27	Salcë : të jëtë e cilësisë së parë, prodhim domate ngjyrë të kuqe, masë e njëtrajtshme, shije dhe erë karakteristike të salcës së domates, e ambalazhuar në shishe qelqi jo me te mëdha se 1 kg ku të jëtë shënuar origjina, data e prodhimit dhe skadencës.	
28	Rigon i paketuar në qeska : te ketë erën dhe shijen karakteristike, I ambalazuar mirë në qeska plastike 100 gr dhe i mbrojtur nga lagështira. Të mos jetë i dëmtuar dhe të përmbushë standartet e tregut.	

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

1	2	3	4
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia e pritshme
1	Sheqer	kg	800
2	Oriz	kg	1700
3	Makarona	kg	1500
4	Vaj Vegjetal	litra	1000
5	Miell orizi	kg	60
6	Miell gruri	kg	200
7	Niseshte	kg	60
8	Recel frutash (jo fiku)	kg	240
9	Biskota	kg	150
10	Kripe industriale	kg	200
11	Mish vici	kg	1800
12	Mish pule	kg	1800
13	Proshute	kg	50
14	Qumesht/kos I fresket	litra	12000
15	Gjalp	kg	350
16	Djath	kg	2000
17	Djath kackavall	kg	100
18	Gjize	kg	400
19	Veze	kokrra	10000
20	Buke	kg	6500
21	Zarzavate	kg	10500
22	Caj mali	kg	10
23	Fruta	kg	800
24	Uthull	kg	10
25	Vaj Ulliri	litra	200
26	sode buke e paketuar me qeska	kg	1
27	salce domatesh	kg	200
28	Rigon I paketuar me qeska	kg	1

*** Sasi të e pritshme te shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 12 mujore (1 vit), dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.**

Dokumentat Standarde të Tenderit

Afatet e lëvrimit: 12 (dymbëdhjete) muaj duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Furnizimi do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor

Afatet e lëvrimit: 12 (dymbëdhjete) muaj duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Per artikujt ushqimor si :qumeshti/kosi, mishi veza, zarzavatet, gjiza, djathi etj. levrimi do te behet me sasi ditore, te cilat porositen 1 dite para nga Spitali Fier, ndersa per artikujt e tjere ushqimore si vaj , oriz, sheqer, recel, makarona, kripe, levrimi do te behet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor .



Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Public Health Sector

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha

dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakëtuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakëtuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimin.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave*

botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

